




Antigonea, qyteti i ëndrrave të Pirros


Një histori e shkurtër

Antigonea u themelua nga Pirro, mbreti i Molosëve, në vitin 295 para Krishtit. Molosët ishin një nga tre fiset e Epirit (në jug të Shqipërisë së sotme dhe veri të Greqisë), i cili u kthye në një shtet të fortë gjatë kësaj periudhe. Antigonea u zhvillua si një qendër e rëndësishme ekonomike, sociale, kulturore e politike dhe në fund të shekullit III dhe në fillim të shekullit II para Krishtit mori formën e "polis" (qytet – shtet) dhe u kthye në një nga vendet më të rëndësishme të antikitetit.



Pirroja i vuri emrin qytetit Antigonea – sipas emrit të gruas së tij të parë, vajza e fisnikëve Maqedonas, Berenis dhe Filipit. Më vonë Berenis u martua me Ptolemeun, mbretin e Egjiptit dhe pasardhës i Aleksandrit të Madh, në oborin e të cilit Pirro u njoh me Antigonenë. Përveç gruas së tij, Pirroja ndërroi edhe vjehërin – Berenisën duke i vënë emrin e saj një qyteti të Epirit.

Kur Pirro ishte 17 vjeç, rrefen historiani i lashtë grek Plutarku, një kryengritje e rrëzoi atë nga fronin. Fillimisht ai kaloi në shërbim të mbretit Dhimitër të Maqedonisë e më vonë u dërgua në oborin e Ptolemeut. Sipas shkrimeve të Plutarkut, "meqënëse Pirro ishte shumë i aftë të bënte për vete njerëzit e fortë,



urrente frikacakët, dhe mbi të gjitha ishte shumë i sjellshëm dhe i urtë në jetë", ai u zgjodh midis shumë princërve të tjerë të marthoj me Antigonenë. Kjo martesë e lartësoi më shumë figurën dhe emrin e mirë të Pirros. Duke pasur dhe ndihmën e gruas së tij të mënçur, Pirroja arriti të mbledhë të holla e ushtri dhe u nis kështu në Epir për të rimarrë fronin mbretëror.

Antigonea, qyteti i dytë i provincës Epirote të Kaonias, pas Finiqit, si nga përmasat ashtu dhe nga rëndësia, kontrollonte të famshmen Via Egnatia që lidhte Dyrrachium (Durrësin), me Apolloninë dhe Orikumin me malësitë e Janinës dhe Epirit jugor. Për shkak të pozitës së rëndësishme gjeografike, në një pikë dominuese mbi kodrën Jerma, në mes të luginës së Drinos, Antigonea u bë e njohur si përfaqësuese e kulmit të zhvillimit ekonomik. Luginë e Drinos, për shkak të pjelloresë dhe rëndësisë strategjike ishte një vend i populluar herët, e dëshmuar kjo nga rreth 20 qytete antike dhe fortifikime, varre, monumente, tempuj të lashtë dhe teatro. Pa dyshim, Antigonea ka qenë qendra kryesore e luginës mes Selosë së Dropullit të Sipërm afër kufirit grek në jug të Adrianopolisit dhe deri lart në Lekël, në fundin verior të luginës.

Qyteti antik i Antigonesë shtrihet në pozicion zotërues dhe strategjik në luginën e Drinos. Qyteti në formë delfini shtrihet në një varg kodrash midis dy kreshtave që lidhen me njëra-tjetrën me një shteg të ngushtë. Sipërfaqja urbane e qytetit brenda dhe jashtë fortifikimit llogaritet të ketë qenë rreth 60 ha. Qyteti ishte i rrethuar nga mure solide rreth 4,000 m gjatësi, që mbronin qytetin nga të gjitha anët, veçanërisht në pjesën jugore dhe perëndimore ku rreziku ishte më i madh për shkak të terrenit. Muret fortifikuese dhe ato të shumicës së shtëpive të zbuluara deri tani janë bërë me blloqe të madhësive të mesme e të mëdha guri gëlqeror, të marra nga gurorja e malit të Lunxhërisë. Askund tjetër si në Antigone, krahasimisht me shumë qytete të tjera të fortifikuara në maja malesh, tipike për qytetet e lashta të zbuluara në Shqipërinë e sotme, arkeologët kanë mundësi të studiojnë



Sistemi rrugor i Antigonesë në lashtësi

i ngjashëm me shumë qytete helene të Greqisë. Për herë të parë në qytetet e lashta në Evropë elementet urbane dhe arkitektonike të zbuluara, japin një ide të planifikimit të qytetit, duke treguar se Antigonea është ndërtuar me urdhër, dhe nuk pati zhvillim ndër vite.



Disa objekte të vogla rurale jashtë mureve rrethues, dhe veglat bujqësore të zbuluara gjatë gërmimeve si gurët e mullirit dhe enët qeramike për përpunimin e produkteve bujqësore tregojnë se qyteti ishte një territor bujqësor i zhvilluar mirë, diçka për të cilën rajoni është edhe sot i famshëm.

Në vitin 198 para Krishtit, ushtria romake mposhti ushtrinë e Filipit V, mbretit të Maqedonisë afër Antigonesë. Ashtu siç raportohet nga gjeografi Strabo, në vitin 167 para Krishtit, Antigonea dhe 70 qytete të tjera të Epirit u shkatërruan nga ushtria e Amilii Paullus, i cili mori hak për dëmet e shkaktuara Italisë nga Lufta e Pirros. Ekzistenca e mëtejshme e qytetit dëshmohet vetëm nga rrënojat e një kishë të vjetër dhe të disa gjendjeve mozaik e Shën Kristoforit dhe një embleme greke që dëshmon ekzistencën e qytetit në periudhën paleo-kristiane. Kjo kishë ishte godina e fundit e ndërtuar në Antigonenë e lashtë. Ajo u shkatërrua gjatë sulmeve sllave në shekullin VI pas Krishtit.

një nate me urdhër të gjeneralit Romak Amilii Paulus si hakmarrje në shenjë urrejtje, e grumbulluar gjatë dy shekujve.

Gjetje arkeologjike

Antigonea përfaqëson historinë e saj sfiduese me gjetjet arkeologjike nga shekulli III dhe II para Krishtit dhe disa godina që i përkasin periudhës së hershme të Kristianizmit. Nuk është gjithmonë e lehtë të gesh emrin e lashtë të rrënojave të një qyteti, por një numër monedhash të rumbullakta prej bronzi me mbishkrimin "ANTIGONEON" janë dokumentat e para epigrafike që lejojnë identifikimin e sigurtë. Deri në mesin e viteve '60, territori i qytetit të Antigonesë quhej Kalaja e Jermës nga vendasit. Arkeologut shqiptar Prof. Dhimosen Budina, që ka udhëhequr rreth 25 ekspedita arkeologjike për zbulimin e Antigonesë, i përket merita e madhe shkencore e identifikimit të Antigonesë nëpërmjet mbishkrimeve në teresat e votimit.




Ekspeditat arkeologjike kanë gërmuar dhe gjetur një numër të madh artikujsh të jetës së përditshme të bëra prej metali apo argjili. Inventari i pasur, i lidhur me artizanatin dhe bujqësinë tregon se këta sektorë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në jetën ekonomike të qytetit. Mbetjet arkeologjike përfshijnë: kosa, çengela, dalta, sqeparë, çekiçë, kompasë dhe vegla të tjera të ndryshme prej bronzi dhe të dekoruara me figura kafshësh apo qenie mitologjike si Poseidoni, Sfinksit apo sirenat. Të paktën një pjesë e këtyre objekteve janë produkte të zonës, gjë që provohet nga punishtet në të cilat ato u gjenden. Gjithashtu ishin të zhvilluara degë të tjera si përpunimi i lëkurës, gurë-gdhëndja, dru-gdhëndja etj. Artikuj të shumtë prej porcelani dhe qeramike të për-

dorimit të përditshëm, objektet artistike, kallëpet për format e tyre, një numër i madh pllakash dhe enësh qeramike (për përpunim produktesh bujqësore)



shumica e të cilave janë nga Epiri dhe të tjerat nga Abrakia (Arta), Kerkira (Korfuzi), Maqedonia, Dyrrachium (Durrësi), Apollonia, Orikumi, Korinthi, etj. Këto gjetje numizmatike tregojnë qartë marrëdhëniet e ngushta tregtare mes Antigonesë dhe qyteteve e shteteve të tjera helene. Marrëdhëniet tregtare reflektohen gjithashtu në artikujt e ndryshëm të importuar nga Greqia si qeramika me vernik të zi, pagure nga Rodhos etj., nëpërmjet të famshmes Via Egnatia dhe rrugëve të tjera që kalonin përgjatë Bregut.

Pjesa më e madhe e inventarit të gjetjeve arkeologjike në Antigone ruhet sot në Muzeun Historik Kombëtar dhe Muzeun Arkeologjik të Tiranës.



nga tre bazilikat paleokristiane brenda qytetit antik dhe me disa kisha në fshatrat fqinje. Manastiri eremit i Spilesë, Kisha e Shën Kollit në Saraqinishtë, Mozaika Paleokristiane në Antigone, janë dëshmi të qarta të përqafimit dhe përhapjes së Kristianizmit në këtë zonë dhe në gjithë Luginën e Drinos. Periudha Otomane ka lënë gjurmët e saj në shtëpitë me arkitekturën e shekullit XVII – XVIII në Tranoshishtë, Krinë dhe Saraqinishtë, ndërkohë që stili i periudhës komuniste mund të shihet në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore të quajtura me emra partizanësh si Arshi Lengo dhe Asim Zeneli.

Parku Arkeologjik i Antigonesë

Parku Arkeologjik i Antigonesë u krijua ligjërisht në 2005 dhe mbulon një zonë rreth 92 ha (zona kryesore). Së bashku me parqet e Kalasë së Shkodrës, Lezhës, Apollonisë, Byllisit, Amantias, Orikumit, Finiqit dhe Butrintit, formon sistemin shqiptar të parqeve arkeologjike. Antigonea ka një zyrë administrate që prej vitit 2007, me 6 punonjës.



Si shkohet në Antigone?
Me makinë: Rruga 14 km që të çon në Parkun Arkeologjik të Antigonesë është e shtruar me asfalt dhe mund të përshkohet me çdo lloj automjeti. Me këmbë: Nga sheshi qëndor i fshatit Asim Zeneli, nëpërmjet një shtegu këmbësorësh, duke ndjekur tabelat orientuese, mund të shkohet në park për 2 orë.

Orari i parkut
Nga e hëna në të premte: 8:00 – 16:00
Të shtunave e të dielave: 8:30 – 15:30
Pranojmë vizitorë edhe jashtë orarit me një autorizim të veçantë me shkrim nga Drejtori i Parkut dhe të shoqëruar nga personeli i parkut.

Informacion mbi vizitat në park
Bileta e hyrjes kushton 200 Lek.
Për nxënësit e shkollave, studentët dhe personat me aftësi të kufizuar bileta kushton 100 Lek.
Çdo të shtunë të fundit të muajit, hyrja është pa pagesë.
Biletat mund të blihen në zyrën e Administratës së Parkut në sheshin qëndror të fshatit Asim Zeneli ose në portën e parkut.

Shërbimet
Mini-muzeu ofron ekspozita për gërmimet dhe aktivitetet e tjera të parkut. Aty mund të blihen suvenire dhe guida për parkun.
Parku arkeologjik i Antigonesë ofron shërbim guidë për vizitorë në grupe nga 5 persona e lartë, ujë të pishëm nga krojet antike, mjedise për glodhje dhe piknik.
Parku Arkeologjik i Antigonesë bën përpjekje të vazhdueshme që ta bëjë qëndrimin tuaj sa më të këndshëm.

Na duhet mbështetja juaj!
Lutemi ndihmoni ta mbajmë Parkun në gjendje të mirë. Mos hidhni mbeturina dhe kur të dilni nga parku, merrni me vete të gjitha mbeturinat tuaja.
Mos shkelni mbi rrënojat e mos u mbështetni në kolona. Është rreptësisht e ndaluar ndezja e zjarrit në park.

Antigonea

PARK ARKEOLOGJIK

Objekte dhe vende me interes

(shih numrat në hartë)

1 Mbetjet nga muret e fortifikuara (fillimi i shek. III para Krishtit) mund të shihen tek shtrihen nëpër kodër. Pamja e tyre është veçanërisht e bukur nga Akropoli.

2 Nimfa e lashtë e Akropolit (fillimi i shek. III para Krishtit). Ndërtesë kulturi që në lashtësi konsiderohej vend i shenjtë i shpirtit femëror. Eshhtë e rrethuar dhe ka shërbyer si burim uji.

3 Kisha e Shën Mëhillit (Saint Michael) (shek. VI-IX pas Krishtit), me përmasa 8m x 7.3m ndodhet në pikën më të lartë të Akropolit dhe ka dy seksione. Rrënojat e saj u zbuluan në 1973 dhe materialet e ndërtimit janë marrë nga muret mbrojtëse të Akropolit.


4 Fortifikimet Mbrojtëse të Akropolit (fillimi i shek. III para Krishtit). Fortifikimet janë formuar nga 3 breza muresh mbrojtëse që ngushtohen deri në majë të kodrës. Pjesa e jashtme është formuar nga mure mbrojtëse dhe shtatë kulla përfunduese.

5 Godinë (punishtja e lëkurës) (gjysma e dytë e shek. të III para Krishtit). Zbuluar gjatë gërmimeve arkeologjike në 1968, është një godinë me një dysheme të çrregullt, përbërë nga një korridor dhe pesë seksione me funksione të ndryshme. Zbulimet e kryera këtu përfshijnë qeramikën si: enë qeramike për përpunimin e produkteve bujqësore, pjata kuzhine, tulla, pjata bronzit dhe vegla pune prej hekuri, të cilat mendohet të jenë përdorur për përpunimin e lëkurës.

6 Fragmente të mureve rrethuese të fortifikuara (fillimi i shek. III para Krishtit). Rrënoja të portës veriore me dy kulla.

7 Godinë (shtëpia e karrocierit) (gjysma e dytë e shek. III para Krishtit). U quajt kështu nga arkeologu Dh. Budina pasi këtu u zbulua një rrotë e madhe karroce që dëshmon se antonanasit lëvizimin me karroca në rrugët e shtruara dhe të drejta të qytetit. Veç kësaj këtu janë gjetur dhe monedha.

8 Godinë (gjysma e dytë e shek. III para Krishtit). Rezidencë banimi me një dysheme në formë L-je, e përbërë nga një korridor dhe pesë kthina. Zbulimet e bëra këtu në 1968 kanë



qenë me shumë vlerë dhe të shumta në numër: pjata bronzit, vegla pune, monedha bronzit dhe argjendi, vula argjili, një mini statujë e Poseidonit (Zoti i oqeanit), si dhe 14 tesera bronzit me emrin e qytetit, që konsiderohen si karta identifikimi për votim. Në këtë shtëpi u gjet një figurinë mitologjike bronzit që konsiderohet si sfinks apo sirenë dhe që sot shërben si logo dhe simbol i Antigonesë. Në mitologjinë Greke dragoi është një zanë me krahë, e mirënjohur si vjedhëse e ushqimit nga profeti Fines.

9 Banesë me varg kolonash (peristili) dhe dysheme me mozaik (fillimi i shek. III para Krishtit). Në arkitekturën romake dhe greke një varg kolonash është një kollonadë që rrethon një kopësht apo një oborr brenda një ndërtese. Zbulimet: dy varre fëmijësh, qeramika, objekte bronzit dhe monedha.


10 Kroj i lashtë (data e papërcaktuar). Ndërtuar pranë një burimi që vazhdon të rrjedhë edhe sot ujë të pijshëm. Arkitektura e tij gjendet e imituar në krojet e Lunxhërisë.

11 Varr Monumental (shek. III-II para Krishtit). Varr i lashtë i stilit maqedonas, i përbërë nga dy bazamente të lidhura me njëra-tjetrën. Muret janë të suvatuara, tavani është i stilit kupolë i bërë me hark. Zbuluar gjatë gërmimeve në vitin 2005. Zbulimet janë qeramika dhe objekte bronzit.

12 Porta Kryesore e Qytetit të Lashtë me dy kulla të fortifikuara (shek. III-II para Krishtit) Zbulimet: gjurmë të instalimit të dy krahëve lëvizës të Portës së Madhe.

13 Stoa ose shëtitorja me mure shumë të bukur me shumë kënde (fillimi i shek. III para Krishtit). Vendosur rreth 250 m larg murit kryesor mbrojtës të qytetit nga jugu. Zbulimet përfshijnë: një mur me stil poligonal, qeramika dhe monedha. Në afërsi ka patur një nimfë.

14 Bazilika Paleo-kristiane (kishë trikonkëshe) dhe mozaiku unikal shumëngjyrësh (shek. V-VI pas Krishtit). Kisha ka formën e një bazilike trikonkëshe me 3 gjysma harku në anët e sheshit qëndror të kishës, me përmasa 13.8 m gjatësi dhe 4.6 m gjerësi. Mozaiku ka në qendër figurinën e një njeriu me kokë qeni, motive gjeometrike nga bota bimërore dhe shtazore. Zbuluar gjatë gërmimeve në 1974.




Parku Arkeologjik i Antigonesë



Legjendë

- Rrugë e pashtuar
- Shteg i shkurtër
- Shteg i gjatë
- Mur i vjetër
- Mur i vjetër i supozuar
- Bazilika Paleo-kristiane
- Përrua
- Izoipsi, 10m
- Izoipsi, 50m
- Objekte dhe vende me interes Mini-muze
- Kufijtë e parkut
- Zonë tampon (e mbrojtur)



Paraqitja e dyshemesë mozaik në Bazilikë



15 Sistemi i fortifikimit jugor (shek. III-II para Krishtit) është një strukturë lineare 800 metra, me 5 kulla mbrojtëse dhe një portë të vogël nga jugu. Eshhtë seksioni më i rëndësishëm i sistemit të fortifikimit të qytetit dhe daton në shek. III para Krishtit. Stili i përdorur në konstruksionin e tij quhet "izodomik" (i rregullt, me blloqe pothuajse katror, të shtrira horizontalisht). Pesë kullat përbëhen nga dy konstruksione metalike të përfunduara me binarë. Janë ndërtuar në formë drejtkëndëshi me shumë se 6 m të larta dhe të gjera në distancë 60 m larg njëri-tjetrit.



16 Agora (Pazari) dhe Stoa Kryesore (shëtitorja me çati) (shek. II-III para Krishtit) ka një plan drejtkëndësh me përmasa 59.6 m x 8.6 m dhe është dekoruar me kollona me stilin Dorik. Një kanal unikal dranzhimi kalon mospërmasë tij. Në 1987 janë gjetur këtu figurina bronzit të Poseidonit dhe Qenit Mollos, si dhe fragmente bronzit të një statujte monumentale të një kalorësi të panjohur (helmete kali, jele kali dhe duart e kalorësit me një unazë në gisht).



Harta: David Dehnert



Rikonstrukcion hipotetik i banesës me kolona (peristil)



Guri matës



Gërmime arkeologjike

17 Banesat dhe ndërtesat publike (shek. III-II para Krishtit). Gjatë gërmimeve të vitit 1986 u zbulua një ndërtesë me kolona (peristil) pranë kishës mesjetare, me përmasa 18 m x 8.5 m. Bazuar në vendndodhjen e saj në qendër të qytetit, arkitekturën dhe mungesën e objekteve për përdorim të përditshëm, kjo ndërtesë supozohet të ketë qenë një ndërtesë publike apo vilë.

18 Kisha Paleo-kristiane e periudhës Bizantine, ndërtuar midis shekujve VII - IX pas lindjes së Krishtit me gurë dhe kolona nga shtëpitë antike. Kisha mesjetare e shekujve IX-XI ka një altar të vetëm me përmasa 11m x 3.5m. Janë zbuluar 13 varre në varrezat pranë kishës, me inventare të pjesëshme.

19 Kompleksi i banesave me kolona persili. Kjo pjesë e qytetit, me shtëpitë dhe kanalet, tregon në tërësi zhvillimin urban të qytetit. Objektet në këtë bllok (të gjitha të gjysmës së parë të sheku-llit III pas lindjes së Krishtit) janë: një godinë për punime zejtarie, një objekt për punime tekstil, guri matës dhe një sistem kanalizimi mbikëqësor. Këtu janë gjetur pjata qeramike për përdorim të përditshëm, tregulla qeramike, vegla për punime artizanale, kundrapesa tezgjahu, monedha bronzit, artikuj dekorativë prej bronzit dhe vegla bujqësore.

Ndërtesat e këtij blloku variojnë në varësi të tipit dhe funksionit të tyre:


- Ndërtesat me një kolonë drejtkëndëshe, rrethuar me hapësira për jetesë dhe aktivitet ekonomik.
- Ndërtesa me një oborr dhe një portë të vendosur në njërin anë apo në të dy anët e oborrit.
- Një ndërtesë me një korridor të ngushtë në mes dhe hapësira në të dy krahët.
- Banesat që kanë oborr që ndodhet në një cep të shtëpisë.

Etiketimi i këtyre shtëpive është bazuar në funksionin e tyre – të përcaktuar nga veglat dhe objektet e tjera të gjetura aty:

Shtëpia e zejtarit, me përmasa 35m x 15m, me një sipërfaqe 335 m2, daton në gjysmën e dytë të shek. III para Krishtit. Zbulimet e bëra këtu janë pjata bronzit, vegla hekuri si sëpatë, hanxhar, kosë, hekur e bronz të ndryshkur, monedha të ndryshme, doreza prej bronzit e një pjatë të formën e një figurine sfinksit, qeramika, etj. Për shkak të metaleve të ndryshkura dhe zbulimeve të tjera, kjo shtëpi është gjykuar që është shtëpia e një zejtarit.

20 Shpella natyrale ndodhet në kodrën lindore shkëmbore. Në antikitet ka shërbyer si mbrojtje natyrale, pjesërisht e fortifikuar me një mur me shumë kënde. Sipas shkrimtarëve antikë, shpella është përdorur si strehim nga banorët gjatë sulmeve nga pushtuesit dhe sot konsiderohet si zonë historike.

Zona qëndrore e gërmimeve



Harta: David Dehnert

Legjendë

- Mur i vjetër
- Mur i vjetër i supozuar
- Bazilika Paleo-kristiane
- Guri matës
- Objekte dhe vende me interes




Adresa e kontaktit: Parku Arkeologjik i Antigonesë Fshati Asim Zeneli, Komuna e Antigonesë Cjrokastër, Shqipëri Tel/Fax +355 (8829) 3155 E-mail: parkuantigonea@yahoo.com Website: www.antigonea.com



Kjo guidë u përgatit nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Parku Arkeologjik i Antigonesë



në kuadrin e Programit të Përbashkët të OKB "Kultura dhe Trashëgimia për Zhvillimin Ekonomik dhe Social", financiar nga Fondi spanjoll i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit.



dhe në bashkëpunim me



Shprehim mirënjohjen tonë për vullnetarët e Korpusit të Paqes, Allan Zaretsky dhe Seth Pyenson, për ndihmën e tyre në realizimin e kësaj guide.

Hartat Arkeologjike: David Dehnert, Shpresa Gjongecaj, Kostadinos Zahos

Foto: Alket Islami, Engjëllush Serjani, Ekipi i Programit të Përbashkët të OKB (Stephan Doempke) Figura: Dhimoshten Budina, Oliver Gilkes, UNESCO

Përcaktimet e përdorura dhe paraqitja e materialit në të gjithë këtë botim nuk nënkupton shprehjen e ndonjë opinioni nga ana e UNDP ose UNESCO-s lidhur me tematikën e këtij botimi.

Design: Delta Print, Tel. (04) 2244-701, deltaprint@albamail.com

© Parku Arkeologjik i Antigonesë 2010